



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2019:228564
Datë: 03.04.2024
Numri i dokumentit: 05541227

C.nr.367/18

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, me gjyqtarin Jeton Zymeri, në çështjen juridike kontestimore të paditëses B... me seli në Prishtinë, rruga ... kundër të paditurit N.P nga fshati ..., Komuna e Vushtrrisë, me objekt kontesti Rimbursim i dëmit, me vlerë të kontestit 11,874.80 euro, në seancën përgatitore të mbajtur me datë 03.04.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

KONSIDEROHET e tërhequr padia C.nr.367/18 e datës 15.08.2018, e paditëses B... me seli në Prishtinë, rr. ..., kundër të paditurit N.P nga fshati ..., Komuna e Vushtrrisë, me objekt kontesti rimbursim dëmi.

A r s y e t i m

Paditësja B... me seli në Prishtinë, rruga ... në këtë gjykatë ka parashtruar padi kundër të paditurit N.P nga fshati ..., Komuna e Vushtrrisë, me bazë juridike-Rimbursim dëmi me vlerë të kontestit 11,874.80 euro.

Në seancën përgatitore të mbajtur me datë 03.04.2024, nuk ka prezantuar paditësja dhe mungesën nuk e ka arsyetuar edhe përkundër thirrjes së rregullt siç konstatohet nga fletëkthesa e datës 19.04.2024, po ashtu nuk ka prezantuar i padituri N.P, për të cilin në bazë të fletëkthesës së datës 13.03.2024, është konstatuar se i njëjti është shpërngulur nga fshati

Marr parasysh faktin se në seancë nuk ka prezantuar paditësja dhe mungesën nuk e ka arsyetuar, gjykata bazuar në nenin 409 par.1 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI

Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil

C.nr.367/18, me datë 03.04.2024

Gj y q t a r i

Jeton Zymeri

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh nga marrja e të njëjtit, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.